



Ndërtesa e Elektrokosovës Elektrokosova Building
Bulevardi Bill Klinton nr.5 Bill Clinton Boulevard no.5
Prishtinë 10000 Prishtina 10 000
Republika e Kosovës Republic of Kosovo



KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM ME ENERGIJE ELEKTRIKE - KEDS SH.A.
KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION COMPANY - KEDS J.S.C.
KOSOVSKA PRUŽIOVACE ZA DISTRIBUCIJU ELEKTRIČNOM ENERGIJOM - KEDS D.O.O.

KEDS - SH. A.

Nr. 31 Dt. 27.4.2026
HQJ

Ymer Fejzullahu
Kryesues i Bordit të ZRRrE-së

Alpin Dogan
Kryeshf Ekzekutiv
KEDS sh.a.

27 Prill 2026

Lënda: Komentet e OSSH-së ndaj Raportit Konsultativ të ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2026

I nderuar z. Fejzullahu,

Ky dokument përmbledh komentet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ndaj Raportit Konsultativ të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2026.

OSSH vlerëson mundësinë e dhënë për të dhënë komente mbi çështjet e rëndësishme të ngritura në Raportin Konsultativ dhe kërkon nga ZRRE që të shqyrtojë me seriozitet të gjitha çështjet e ngritura para çdo vendimi përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026.

OSSH është e hapur dhe e gatshme për diskutime të mëtejshme sa herë që është e nevojshme.

Me respekt,


Alpin Dogan
Kryeshf Ekzekutiv, KEDS sh.a





Ndërtesa e Elektrokosovës
Bulevardi Bill Klinton nr. 5
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

*Elektrokosova Building
Bill Clinton Boulevard no.5
Prishtina 10 000
Republic of Kosovo*



Komentet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ndaj Raportit Konsultativ të ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2026

Prill, 2026



1. Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me 10 Prill 2026 ka publikuar Raportin Konsultativ lidhur me përshtatjet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) për Operatorin e sistemit të shpërndarjes (OSSH), për vitin tarifor 2026. Në këtë raport, ZRRE ka paraqitur vlerësimin fillestar për të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH, bazuar në aplikimin e OSSH të dorëzuar me 23 Janar 2026.

Në vijim të këtij dokumenti OSSH do të paraqes qëndrimin e saj lidhur me vlerësimin fillestar të ZRRE-së për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026.

2. Kostot operative dhe të mirëmbajtjes (OPEX)

Në aplikimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2026, OSSH ka propozuar rritje të kostove operative, duke reflektuar zgjerimin e bazës së konsumatorëve dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve. Megjithatë, një element thelbësor që ka ndikuar në rritjen reale të kostove operative gjatë vitit 2025 dhe që vazhdon të ketë efekt të drejtpërdrejtë edhe në vitin 2026, lidhet me hapjen e tregut të energjisë elektrike.

2.1. Kostot që ndërlidhen me hapjen e tregut

Hapja e tregut ka sjellë një transformim të konsiderueshëm të rolit dhe përgjegjësi të OSSH-së, duke gjeneruar kërkesa të reja operative, teknike dhe administrative që nuk kanë qenë të parashikuara në bazën ekzistuese të OPEX-it të aprovuar në kuadër të MYT3.

Këto obligime shtesë përfshijnë, ndër të tjera, rritjen e aktiviteteve në terren për identifikimin dhe verifikimin e konsumatorëve që kalojnë në treg të hapur, menaxhimin e rasteve të konsumatorëve pa furnizues, realizimin e shkyçjeve dhe rikonektimeve, rritjen e komunikimit dhe koordinimit me furnizuesit e rinj, si dhe kërkesa të shtuara për përpunim, validim dhe shkëmbim të të dhënave në afate dukshëm më të shkurtra. Për më tepër, operimi në një treg të liberalizuar ka kërkuar angazhime shtesë administrative, teknike dhe IT, përfshirë zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve mbështetëse dhe menaxhimin e proceseve të reja të tregut.

Vlen të theksohet se i gjithë ky proces është menaxhuar gjatë vitit 2025 pa rritje të numrit të stafit, kryesisht përmes angazhimit të burimeve ekzistuese njerëzore, të cilat kanë operuar nën ngarkesë të konsiderueshme shtesë. Një numër i konsiderueshëm i punonjësve, si në operacionet në terren ashtu edhe në funksionet administrative dhe mbështetëse, kanë qenë të angazhuar përtej orarit të



rregullt të punës për të siguruar funksionalizimin e këtij procesi. Këto zhvillime nuk kanë mundur të realizohen brenda kapaciteteve normale operative dhe përfaqësojnë kosto reale shtesë që duhet të reflektohen në mënyrë adekuate në vlerësimin e OPEX-it.

Për më tepër, është e qartë se funksionimi i tregut të liberalizuar ka kërkuar angazhime shtesë në aspektin teknologjik dhe operacional, përfshirë zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve mbështetëse, përshtatjen e proceseve ekzistuese dhe angazhimin e burimeve shtesë njerëzore për menaxhimin e proceseve të reja të tregut.

Vlen të theksohet se gjatë procesit të hapjes së tregut, ZRRE në vazhdimësi kishte adresuar që kostot shtesë operative të lidhura me këtë proces do të trajtohen në kuadër të vlerësimeve tarifore. Në këtë drejtim, OSSH në aplikimin tarifor kishte kërkuar që si bazë për vitin 2026 të merren kostot reale të realizuara gjatë vitit 2025, të cilat tashmë reflektojnë ndikimin faktik të hapjes së tregut.

Megjithatë, në kuadër të Raportit Konsultativ, këto kosto nuk janë reflektuar fare në vlerësimin e OPEX-it, pavarësisht faktit se ato përfaqësojnë kosto reale, të vazhdueshme dhe strukturore, e jo shpenzime të përkohshme.

Duke qenë se hapja e tregut dhe kostot përcjellëse nuk kanë qenë të njohura dhe as të përfshira gjatë përcaktimit të OPEX-it në kuadër të MYT3, mos-reflektimi i tyre krijon një mospërputhje të qartë ndërmjet obligimeve të zgjeruara rregullative dhe operacionale të OSSH-së dhe nivelit të të hyrave të lejuara. Për më tepër, kjo qasje rrezikon të kufizojë kapacitetin operacional të OSSH-së për të përmbushur fazat e ardhshme të zhvillimit të tregut të hapur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme.

2.2. Kostot operative dhe të mirëmbajtjes

Përveç kostove shtesë që ndërlidhen me hapjen e tregut, vlen të theksohet se realizimi i OPEX-it gjatë vitit 2025 rezulton më i lartë krahasuar me nivelin e aprovuar në kuadër të MYT3, si rezultat i një sërë faktorësh që kanë ndikuar drejtpërdrejt në strukturën reale të kostove operative të OSSH-së.

Megjithëse ZRRE ka aplikuar mekanizmin e indeksimit përmes normës së inflacionit, ky mekanizëm nuk ka qenë i mjaftueshëm për të reflektuar rritjen reale të kostove në treg. Rritja e vazhdueshme e çmimeve të shërbimeve, materialeve dhe produkteve operative ka qenë dukshëm më e lartë sesa niveli i inflacionit prej 2.13%, veçanërisht kur krahasohet me periudhën e vitit 2023, mbi të cilën është ndërtuar baza e OPEX-it për periudhën e tretë rregullative.



Në praktikë, një pjesë e konsiderueshme e inpleteve operative të nevojshme për funksionimin e rrjetit kanë shënuar rritje shumë më të larta të çmimeve, dhe në raste të caktuara pothuajse janë dyfishuar krahasuar me periudhën kur është përcaktuar baza aktuale rregullative.

Po ashtu, zhvillimet e fundit në tregjet ndërkombëtare kanë krijuar presion shtesë përmes rritjes së çmimeve të derivateve të naftës, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në kostot operative të OSSH-së, veçanërisht në aktivitetet në terren dhe operimet ditore. Duke qenë se kohëzgjatja e këtyre zhvillimeve mbetet e paqartë, kjo rrit më tej nivelin e pasigurisë për periudhën vijuese.

Të gjitha këto zhvillime përfaqësojnë faktorë që janë jashtë kontrollit të OSSH-së dhe kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kostove operative reale gjatë vitit 2025. Për këtë arsye, OSSH kërkon që ZRRE, në vendimin përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026, të reflektojë nivelin real të kostove të realizuara gjatë vitit 2025 si bazë më përfaqësuese për vlerësimin e OPEX-it, dhe mbi këtë bazë të adresojë edhe ndryshimet e pritshme për vitin 2026.

2.3. Kostot Operative në katër komunat veriore

OSSH në propozimin e saj për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026 ka reflektuar edhe kostot për operim në katër komunat veriore për periudhën Janar - Prill 2025 sipas marrëveshjes së nënshkruar e cila ishte në fuqi deri në aprovimit të MAR për vitin 2025. Përkundër kësaj, ZRRE nuk ka reflektuar këto përshtatje në vlerësimin e saj të paraqitur në raportin konsultativ, edhe pse të njëjtat kosto janë si rrjedhojë e një marrëveshje për të cilën ZRRE-ja ka qenë e njoftuar paraprakisht. Andaj, OSSH insiston që ZRRE-ja në vlerësimin e saj përfundimtar në të hyrat e lejuara maksimale të njeh këto kosto ashtu siç janë realizuar.

Në raportin konsultativ për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026, ZRRE nuk ka paraqitur një trajtim të veçantë dhe të ndarë të kostove operative që lidhen me operimin në pjesën veriore të vendit, ndonëse një qasje e tillë ka qenë e aplikuar në vitet paraprake. Nga analiza e përmbajtjes së raportit, rezulton se ZRRE, në mënyrë implicite, ka marrë për bazë të njëjtin nivel të kostove të lejuara për këtë zonë si ai i aprovuar për vitin 2025, pa reflektuar zhvillimet reale dhe ndryshimet e ndodhura ndërkohë.

Ndërkohë, duke qenë se operimi në pjesën veriore ka hyrë në vitin e tretë, OSSH tashmë posedon një pasqyrë shumë më të qartë dhe të detajuar mbi strukturën reale të kostove, kompleksitetin operacional dhe natyrën e aktiviteteve që zhvillohen në këtë zonë. Këto të dhëna dëshmojnë se supozimi për ruajtjen apo madje uljen e nivelit të kostove për vitin 2026 nuk është i bazuar në realitetin operativ dhe financiar në terren.

Përkundrazi, zhvillimet e fundit në treg, rritja e presioneve nga kontraktorët lokalë, si dhe sfidat specifike që karakterizojnë operimin në këtë zonë, imponojnë një rritje të domosdoshme të kostove



për të siguruar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri të operimit. Këto elemente tashmë janë adresuar në ZRRE përmes komunikimeve përkatëse.

Në këtë kontekst, për të siguruar një reflektim të drejtë dhe real të kostove në përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin 2026, është thelbësore që ZRRE në vlerësimin përfundimtar të adresojë në mënyrë të drejtpërdrejtë specifikat e operimit në pjesën veriore. Konkretisht, kjo zonë duhet të trajtohet si një njësi e veçantë operationale në nivel distrikti, duke marrë parasysh shtrirjen e saj gjeografike, kompleksitetin operacional dhe intensitetin e angazhimeve në terren, të cilat janë të krahasueshme me distrikte ekzistuese si ai i Gjilanit. Në të njëjtën kohë, çdo devijim nga niveli real i kostove të paraqitura nga OSSH, të mbështetura në evidencë konkrete dhe përvojë operative tashmë të konsoliduar, rrezikon të krijojë një hendek të konsiderueshëm ndërmjet kostove reale dhe të hyrave të lejuara, duke lënë hapësirë të rritjes së pakënaqësive të cilat mund të përkthehen në kualitetin e shërbimit në këtë zonë. Për rrjedhojë, është e domosdoshme që ZRRE të reflektojë plotësisht këto kosto në vendimmarrjen përfundimtare për MAR 2026.

3. Kostot e investimeve

Nënshkrimi i marrëveshjes për furnizimin e katër komunave në veri të Kosovës me furnizuesin Elektroserver në vitin 2023 ka mundësuar operimin e OSSH-së në këtë zonë, duke krijuar njëkohësisht nevoja shtesë investive për sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm të rrjetit. Në këtë drejtim, OSSH ka reflektuar në aplikimin e saj tarifor investimet përkatëse të nevojshme për vitin 2026.

Megjithatë, nga analiza e Raportit Konsultativ rezulton se ZRRE ka marrë në konsideratë vetëm investimet bazë që ndërlidhen me operimin në pjesën veriore të vendit, ndërsa nuk ka reflektuar investimet shtesë të paraqitura nga OSSH në aplikimin e dorëzuar më 23.01.2026.

Në mënyrë specifike, OSSH ka paraqitur projekte shtesë investive që lidhen drejtpërdrejt me kërkesat e reja operative të krijuara nga hapja e tregut, përfshirë investimet në teknologjinë informative, sistemet mbështetëse dhe infrastrukturën e nevojshme për menaxhimin e proceseve të reja të tregut, shkëmbimin e të dhënave dhe funksionimin efikas në kushtet e tregut të liberalizuar. Këto projekte nuk përfaqësojnë zgjerim diskrecional të investimeve, por rrjedhin drejtpërdrejt nga obligimet e reja operative dhe rregullatore të OSSH-së.

Po ashtu, OSSH ka kërkuar edhe gjatë vitit 2026 vazhdimin e investimeve në infrastrukturën e matjes, përfshirë zëvendësimin e njehsorëve bazuar në arsyeshmërinë teknike të paraqitur, veçanërisht për njehsorët që mund të paraqiten me probleme teknike dhe për ato që kanë tejkaluar ciklin normal të përdorimit për shkak të vjetërsisë së tyre.



Duke marrë parasysh zhvillimet e fundit operationale, rritjen e kërkesave për saktësi në matje dhe obligimet e reja që rrjedhin nga hapja e tregut, OSSH konsideron se këto investime duhet të reflektohen në mënyrë adekuate në vlerësimin përfundimtar të MAR 2026.

Kjo bëhet edhe më e rëndësishme në dritën e zhvillimeve të fundit rregullatore, ku organet kompetente të metrologjisë në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) kanë intensifikuar aktivitetet inspektuese dhe kanë filluar aplikimin e masave ndëshkuese për rastet kur identifikohen njehsorë me afat të skaduar të verifikimit/plombimit, me gjoha që variojnë nga 3,000 EUR deri në 5,000 EUR për secilin rast të identifikuar.

Këto zhvillime krijojnë ekspozim shtesë financiar për OSSH-në, i cili nuk buron nga joefikasiteti operacional, por nga nevoja objektive për përsheptimin e zëvendësimit të njehsorëve në terren. Për këtë arsye, është e nevojshme që ZRRE jo vetëm të reflektojë këtë realitet në vlerësimin e saj financiar, por edhe të mundësojë përmes aprovimit të investimeve përkatëse implementimin e programit të zëvendësimit të njehsorëve, në mënyrë që të shmangen kostot shtesë dhe rreziqet rregullatore në periudhat vijuese.

Në këto rrethana, nevoja për investime në zëvendësimin e njehsorëve dhe modernizimin e infrastrukturës së matjes nuk përfaqëson vetëm një kërkesë operationale, por edhe një domosdoshmëri për të siguruar përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe për të shmangur ekspozimin ndaj ndëshkimeve shtesë financiare.

Vlen të theksohet se, në mungesë të aprovimit të këtyre investimeve nga ZRRE, OSSH e ka të pamundur të realizojë këto projekte në terren, duke marrë parasysh se çdo investim kapital dhe çdo projekt përkatës kërkon aprovim paraprak në kuadër të kornizës rregullatore. Si rrjedhojë, mosreflektimi i këtyre investimeve krijon një situatë ku OSSH bart obligime operative dhe ligjore pa pasur mekanizmat e nevojshëm financiarë për t'i adresuar ato në mënyrë efektive.

Në këtë kontekst, është e domosdoshme që ZRRE, në vlerësimin përfundimtar të MAR 2026, të reflektojë në mënyrë të plotë këto investime shtesë, duke siguruar përputhshmëri ndërmjet kërkesave të reja operationale dhe kapaciteteve të nevojshme investive të OSSH-së.

4. Kostoja e humbjeve

Gjatë shqyrtimit të vlerësimeve të ZRRE-së të paraqitura në Raportin Konsultativ lidhur me vlerat e realizuara për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026, OSSH ka identifikuar se në përlllogaritjet e ZRRE-së nuk është marrë në konsideratë energjia totale hyrëse në nivelin e shpërndarjes (EED) sipas metodologjisë së aprovuar në Bilancin Vjetor të Energjisë Elektrike dhe Rregullën për të Hyrat e OSSH-së. Në vend të kësaj, është aplikuar një qasje alternative e cila nuk është në përputhje me kornizën ekzistuese metodologjike.



Mos-reflektimi i plotë i energjisë hyrëse në rrjet krijon nënvlerësim të humbjeve të lejuara për vitin 2025 dhe, njëkohësisht, bart një pjesë të kostove reale tek OSSH gjatë vitit 2026, duke krijuar presion financiar në një vit relevant dhe korrigjime potencialisht më të larta në periudhat pasuese. Për të shmangur këto mospërputhje, OSSH ka bazuar përlllogaritjet e saj në energjinë totale hyrëse në shpërndarje, në përputhje me metodologjinë e aprovuar.

Për më tepër, në vlerësimin e saj për vitin 2026, ZRRE nuk ka reflektuar në mënyrë adekuate humbjet e pritshme në pjesën veriore të vendit dhe pa një analizë të detajuar teknike dhe rregullatore, ka aplikuar një reduktim shtesë prej 3 pikë përqindjeje mbi nivelin e humbjeve të aprovuara për vitin 2025.

Një qasje e tillë konsiderohet e parakohshme, duke marrë parasysh se operimi i OSSH-së në pjesën veriore ka filluar vetëm gjatë dy viteve të fundit dhe kompania ende ndodhet në fazën e konsolidimit operacional, identifikimit të investimeve të nevojshme dhe adresimit të sfidave strukturore në këtë zonë.

Për vitin 2025, energjia hyrëse në rrjet dhe konsumi i realizuar përfaqësojnë të dhëna reale dhe të matshme, prandaj edhe vlerësimi i performancës së humbjeve duhet të mbështetet në këto të dhëna faktike dhe jo në parametra hipotetikë.

Për pjesën e rregullt të rrjetit (pa veriun), duke aplikuar cakun e aprovuar të humbjeve prej 13.3% mbi energjinë hyrëse të realizuar për vitin 2025, humbjet e lejuara rezultojnë në 874.917 GWh, ndërsa humbjet reale të realizuara kanë qenë 901.35 GWh.

Për pjesën veriore, duke aplikuar normën ekzistuese prej 21.5%, humbjet e lejuara rezultojnë në 51.92 GWh. Duke marrë parasysh mekanizmin ekzistues të ndarjes 50/50, humbjet e lejuara arrijnë në 55.92 GWh, krahasuar me humbjet reale prej 59.93 GWh.

Rrjedhimisht, këto të dhëna dëshmojnë se ekziston një bazë reale dhe e matshme për vlerësimin e performancës së humbjeve dhe se aplikimi i një reduktimi shtesë prej 3 pikë përqindjeje nga ana e ZRRE-së nuk mbështetet në analizë të mjaftueshme teknike, rregullatore apo në të dhënat reale të realizimit.

Vlen të theksohet se ZRRE, në kuadër të vlerësimit për vitin 2025, kishte përcaktuar një cak prej 21.5% për humbjet në pjesën veriore, pavarësisht faktit se një trajtim i tillë kishte devijuar nga parametrat ekzistues rregullatorë dhe nuk kishte qenë i pranueshëm për OSSH-në. Megjithatë, edhe me këtë cak, humbjet reale të realizuara gjatë vitit 2025 rezultojnë më të larta, ndërsa humbjet e realizuara gjatë vitit 2024 kishin qenë në nivel prej 24.5%. Rrjedhimisht, humbjet e realizuar në vitin 2024 dhe në vitin 2025 janë pothuajse në të njëjtin nivel. Andaj në këto rrethana, aplikimi i një reduktimi të ri prej 3 pikë përqindjeje për vitin 2026, pa një analizë të plotë të performancës reale dhe pa një proces formal të rishikimit të parametrave rregullatorë, rezulton i parakohshëm dhe jo proporcional me realitetin aktual operacional në pjesën veriore të vendit.



Pavarësisht se përcaktimi i një caku të humbjeve në këtë fazë tranzitore vazhdon të paraqesë sfida të konsiderueshme për OSSH-në, një qasje më e arsyeshme dhe më e përballeshme do të ishte që çdo target i ardhshëm të ndërtohet mbi nivelin real të humbjeve të realizuara gjatë vitit 2025, duke reflektuar gradualisht përmirësimet e pritshme dhe realitetin aktual operacional në veri. Aq më tepër, ZRRE, në kuadër të shqyrtimit të parametrave rregullator për periudhën 2023–2027, me Vendimin nr. V_1636_2022, ka përcaktuar qartë se: “Caku i reduktimit të humbjeve dhe lakorja e humbjeve të lejuara nuk aplikohet për sasi të energjisë së pafaturuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës.”

Përderisa nuk është zhvilluar ende një proces formal për rishikimin e këtyre parametrave, çdo reduktim shtesë në këtë fazë konsiderohet i parakohshëm dhe jo në përputhje me realitetin aktual operacional. Për këtë arsye, OSSH kërkon që në vlerësimin përfundimtar të MAR 2026 të reflektohen plotësisht humbjet reale dhe të parashikuara për pjesën veriore bazuar në të dhënat faktike të operimit. Ndryshimet me propozimin e ZRRE-së janë të paraqitura në tabelën më poshtë:

€000s		2025	2026	2026
Inputet për kalkulim	Njësia	Realizimi OSSH	Propozuar - ZRRE	Rishikuar - OSSH
Energjia që hyn në shpërndarje	GWh	6,587.72	6,587.72	6,601.33
Humbjet	GWh	930.85	842.46	870.19
Çmimi i blerjes	€/MWh	108.42	95.85	102.07
Kostot totale	€000s	100,923	80,752	92,70

4.1 Çmimet e blerjes së energjisë për vitin 2026

Në kuadër të aplikimit tarifor të dorëzuar në ZRRE më 23.01.2026, OSSH kishte parashikuar një çmim mesatar të blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve prej 151.31 €/MWh, duke përdorur të dhënat referente të tregut të disponueshme në momentin e përgatitjes së aplikimit.

Ndërkohë, në Raportin Konsultativ, ZRRE ka propozuar një çmim mesatar prej vetëm 129.76 €/MWh, i cili rezulton dukshëm më i ulët krahasuar me parashikimet e paraqitura nga OSSH dhe nuk reflekton në mënyrë të plotë nivelin aktual të ekspozimit ndaj tregut.

Vlen të theksohet se parashikimet fillestare për vitin 2026 janë bazuar në të dhënat forward të datës 1 tetor 2025. Që nga periudha e përgatitjes së aplikimit tarifor, tregjet evropiane të energjisë kanë reflektuar luhatje të konsiderueshme dhe nivel të lartë pasigurie, të ndikuara nga faktorë të ndryshëm, përfshirë zhvillimet gjeopolitike, ndryshimet në prodhimin rajonal dhe lëvizjet në tregjet ndërkombëtare të energjisë.

Në këtë kontekst, gjatë periudhës së konsultimit publik, OSSH ka vlerësuar të nevojshme të kryejë një rivlerësim shtesë të çmimeve, me qëllim që projeksionet për vitin 2026 të reflektojnë në mënyrë më reale kushtet aktuale të tregut.



Përveç reflektimit të çmimeve të realizuara për periudhën janar – mars 2026, OSSH ka zhvilluar gjithashtu një analizë të përditësuar të parashikimeve të tregut me datën 17.04.2026, duke përdorur si referencë dy tregje relevante rajonale, përkatësisht tregun e Greqisë dhe tregun e Hungarisë.

Rezultatet e këtij rivlerësimi paraqiten në tabelën vijuese dhe demonstrojnë nevojën që projeksionet tarifore të reflektojnë në mënyrë më reale zhvillimet aktuale dhe volatilitetin e tregut.


Muaji	Njësia	Rishikimi i çmimeve					
		Propozimi i OSSH-së - 23.01.2026	Propozimi i ZRRE-së 10.04.2026	EEX Hungari 17.04.2026	EEX Greqi 17.04.2026	Mesatarja Greqi - Hungari 2026	Çmimi i Përditësuar nga OSSH 2026
		2026	2026	2026	2026	2026	
Janar	€/MWh	173.76	140.52	140.52	140.52	140.52	140.52
Shkurt	€/MWh	146.92	100.54	100.54	100.54	100.54	100.54
Mars	€/MWh	151.18	128.88	126.87	126.87	126.87	126.87
Prill	€/MWh	95.49	99.90	118.70	102.73	110.72	101.54
Maj	€/MWh	97.21	106.73	123.75	116.45	120.10	108.82
Qershor	€/MWh	91.87	99.09	119.52	119.66	119.59	99.77
Korrik	€/MWh	111.95	111.84	123.00	132.04	127.52	113.36
Gusht	€/MWh	119.17	115.44	128.77	108.46	118.62	116.80
Shtator	€/MWh	119.47	123.96	136.42	121.43	128.93	125.74
Tetor	€/MWh	134.57	134.72	147.83	125.92	136.88	136.97
Nëntor	€/MWh	165.58	156.30	168.15	157.40	162.78	159.68
Dhjetor	€/MWh	175.55	140.52	177.86	152.48	165.17	170.64

Rrjedhimisht, përdorimi i një reference statike të bazuar në një moment të vetëm kohor nuk reflekton në mënyrë të mjaftueshme dinamikën aktuale të tregut dhe rrezikun real të ekspozimit të OSSH-së ndaj kostove të humbjeve.

Për këtë arsye, OSSH ka realizuar një analizë të përditësuar të tregut duke përdorur:

- çmimet forward të tregut hungarez (HUPX/EEX) bazuar në të dhënat e datës 17.04.2026, si çmimet më të fundit të disponueshme në momentin e analizës; dhe
- për qëllime krahasuese dhe transparence, një analizë paralele edhe me tregun grek (HENEX) për të njëjtën periudhë.

Rezultatet tregojnë se çmimet e përditësuara të tregut nuk reflektojnë një trend linear të rënies së çmimeve, por përkundrazi demonstrojnë volatilitet të vazhdueshëm ndërmjet muajve të ndryshëm të vitit 2026. Në disa periudha çmimet rezultojnë më të larta se ato të reflektuara në Raportin Konsultativ të ZRRE-së, duke konfirmuar nivelin e lartë të pasigurisë në treg.



Bazuar në analizën e përditësuar të parashikimit të çmimeve, të paraqitur në tabelën e mësipërme, çmimi mesatar i rishikuar i blerjes së energjisë elektrike nga importi për vitin 2026 rezulton të jetë 138.40 EUR/MWh. Për rrjedhojë, OSSH në përlllogaritjet e rishikuara të paraqitura në kuadër të këtyre komenteve ka përdorur këtë çmim si bazë për vlerësimin e kostos së energjisë së importuar për mbulimin e humbjeve.

Ky vlerësim bëhet veçanërisht i rëndësishëm duke marrë parasysh strukturën e kostove të OSSH-së, ku energjia për mbulimin e humbjeve përfaqëson një komponent material të kostove operative dhe mbetet drejtpërdrejt e ndikuar nga lëvizjet në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare të energjisë.

Për më tepër, analiza historike e vitit 2025 demonstroi se ka ekzistuar një devijim i konsiderueshëm ndërmjet çmimeve të aprovuara dhe kostove reale të realizuara për mbulimin e humbjeve, çka evidenton kufizimet e metodologjive statike të parashikimit dhe nevojën për reflektim më realist të kushteve aktuale të tregut.

Në këtë drejtim, OSSH konsideron se përdorimi i çmimeve të përditësuar, të reflektuara përmes një qasjeje më të balancuar ndërmjet tregjeve referuese rajonale, paraqet një bazë më të arsyeshme, më të verifikueshme dhe më të qëndrueshme për përcaktimin e kostos së humbjeve për vitin 2026.

Mos-reflektimi adekuat i këtyre kostove krijon rrezik të drejtpërdrejtë për rikuperimin e kostove reale të operatorit të shpërndarjes dhe mund të gjenerojë diferenca të konsiderueshme ndërmjet kostove reale dhe të hyrave të lejuara, të cilat më pas transferohen në mekanizmat korrektues tariforë në periudhat pasuese.



5. Kostot tjera

Pjesë përbërëse e të hyrave të lejuara maksimale (MAR) janë gjithashtu të hyrat jo tarifore, obligimet ndaj Operatorit të tregut dhe operatorit të sistemit të transmetimit, si dhe çdo kosto tjetër e arsyeshme që ndërlidhet me ofrimin e shërbimeve të sistemit të shpërndarjes.

5.1. Të hyrat e parregulluara

OSSH vazhdon të mbetet e angazhuar në përmbushjen e objektivave rregullative dhe ofrimin e shërbimit të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjithë konsumatorët. Si pjesë e angazhimit të saj për transparencë dhe efikasitet, procesi i përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale është një komponent kyç në krijimin e një mjedisi financiar të qëndrueshëm dhe motivues për operimin e kompanisë. Ky proces përfshin edhe mënyrën e trajtimit të të hyrave që vijnë nga shërbimet tjera, të cilat klasifikohen si të hyra të parregulluara.

Është thelbësore të kuptohet ndikimi i kornizës rregullative mbi stabilitetin financiar të OSSH-së dhe aftësinë e saj për të investuar në zhvillimin e shërbimeve dhe infrastrukturës. Prandaj, për të adresuar këtë çështje dhe për të nxitur inovacionin në sektor, OSSH propozon zbatimin e një faktori ndarës prej 50% mbi të ardhurat e realizuara nga këto shërbime shtesë. Ky faktor ndarës do të ofronte një ekuilibër të drejtë midis stimulimit të inovacionit dhe përfitimit të konsumatorit fundor, duke mbajtur gjithashtu pajtueshmërinë rregullative të vendosur nga ZRRE.

Në kuadër të Raportit Konsultativ për MAR 2026, ZRRE ka propozuar që të hyrat e parregulluara, të vlerësuara në nivel prej 5.41 milionë euro, të zbriten në tërësi nga të Hyrat e Lejuara Maksimale. Ndërkohë, OSSH në aplikimin e saj ka propozuar një qasje më të balancuar, duke aplikuar një faktor ndarës prej 50%, respektivisht duke reflektuar në MAR vetëm 2.70 milionë euro. Në kundërshtim me këtë, ZRRE në vlerësimin fillestar ka propozuar një mekanizëm më restriktiv, me faktor ndarës 75% në favor të reduktimit të MAR-it dhe vetëm 25% si përfitim potencial për OSSH për të hyrat që tejkalojnë nivelin e parashikuar.

Një qasje e tillë konsiderohet e pabalancuar dhe nuk krijon një mekanizëm të mjaftueshëm stimulues për OSSH-në në drejtim të gjenerimit të të hyrave shtesë. Përkundrazi, ajo dobëson lidhjen ndërmjet performancës dhe përfitimit, duke reduktuar ndjeshëm incentivën për të zhvilluar dhe zgjeruar aktivitetet që gjenerojnë të ardhura jashtë komponentës tarifore.

Në këtë drejtim, OSSH vlerëson se aplikimi i një faktori ndarës prej 50% përfaqëson një zgjidhje më të drejtë dhe më efektive rregullatore, e cila siguron një balancë të arsyeshme ndërmjet interesit të konsumatorëve dhe nevojës për të krijuar stimuj realë për operatorin. Një mekanizëm i tillë jo



Ndërtesa e ElektroKosovës
Bulevardi Bill Kinton nr.3
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

Elektrokosova Building
Bill Clinton Boulevard no.3
Prishtina 10 000
Republic of Kosovo



vetëm që nxit rritjen e të hyrave jo-tarifore, por gjithashtu kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare dhe efikasitetit operacional të OSSH-së.

Për më tepër, OSSH ka identifikuar potencial për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve jo-tarifore, përtej atyre aktualisht të përjashtuara nga MAR. Megjithatë, aplikimi i një faktori të lartë zbritjeje, siç është ai i propozuar nga ZRRE, zvogëlon në mënyrë të drejtpërdrejtë interesin dhe arsyeshmërinë ekonomike për investim në këto aktivitete, duke kufizuar kështu potencialin për diversifikim dhe inovacion në sektor.

Rrjedhimisht, aplikimi i një faktori ndarës prej 50% do të kishte një ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv në likuiditetin dhe stabilitetin financiar të OSSH-së, duke mundësuar njëkohësisht rritjen e kapaciteteve për investime dhe përmirësim të cilësisë së shërbimeve. Në fund, ky mekanizëm siguron që përfitimet nga performanca më e mirë e operatorit të ndahen në mënyrë të drejtë edhe me konsumatorët, përmes një sektori më efikas dhe më të qëndrueshëm.

Në këtë kontekst, OSSH i bën thirrje ZRRE-së që në vlerësimin përfundimtar të MAR 2026 të rishqyrtojë qasjen e propozuar dhe të aplikojë faktor ndarës prej 50%, si një zgjidhje më e balancuar, stimuluese dhe në përputhje me parimet e rregullimit ekonomik.



6. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH-në për vitin 2026

Tabela e mëposhtme përmbledh të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH për vitin 2026, duke marrë parasysh arsyetimin për komponentët e kostove të paraqitura në seksionet e mësipërme të këtij dokumenti.

Të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026		Propozimi i ZRRE-së	Komentet e OSSH-së
It	%	7.96%	7.96%
Kostot e Operimit dhe Mirëmbajtjes (OPMCt)			
$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	29.870	39.39
Kostot shtesë për opex	€m	2.882	
Zhvlerësimi i lejuar (DEPCt)			
$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	23.396	24.61
Kthimi i lejuar (RTNCt)			
$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	19.424	20.08
Obligimet nga KOSTT-it			
		3.633	3.633
Humbjet e Lejuara (LSSCt)			
LSSAt	%		
REUEt	GWh	6,587.72	6,601.33
WHEAt	€/MWh	95.85	102.07
LSACt-1			
LSSCt	€m	80.752	92.70
Përshtatjet			
Të hyrat e parregulluara	€m	-5.408	-2.704
Përshtatjet (2022 & PR2)		0.09	0.09
Kostoja e licencës		0.00	
KREV			
KREV	€m	30.108	39.216
MAR – të hyrat e lejuara maksimale	€m	184.746	217.021

Si përfundim, niveli i të hyrave të lejuara maksimale prej 217.021 milion € paraqet një bazë të nevojshme për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm të OSSH-së, ruajtjen e stabilitetit financiar, realizimin e investimeve të domosdoshme dhe garantimin e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Për këtë arsye, OSSH kërkon që ZRRE, para marrjes së vendimit përfundimtar për MAR 2026, të marrë në konsideratë komentet dhe argumentet e paraqitura më sipër, me qëllim që vendimi final të reflektojë në mënyrë sa më reale obligimet operative, zhvillimet e fundit të tregut dhe kostot faktike me të cilat përballet OSSH.